



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1175/prot.
15

Tiranë, më 23.12.2024

SHPALLJE PUBLIKE

PËR

SHKURTIM VENDIMI DHE DËRGIM INFORMACIONI

Subjekti i rivlerësimit: Klorinda Çela

Në zbatim të neneve 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile, bëhet “Njoftim me shpallje publike” për sa më poshtë:

- Shkurtim vendimi nr. 22, datë 25.11.2024, të trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Informacionin mbi përbërjen e trupit gjykues, nr. 1175/9 prot., datë 25.11.2024, që do të gjykojë çështjen (JR) nr. 1/2022, datë 05.01.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Klorinda Çela.

Ky njoftim do të qëndrojë i afishuar, bashkë me “Shkurtim vendimi nr. 22, datë 25.11.2024”, për jo më pak se 20 ditë, në këndin e Njoftimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të botohet në rubrikën “Shpallje” në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹.

Shpallja është afishuar sot më datë 23 / 12 /2024

(Emër, Mbiemër)
(Nënshkrimi)



(*Ira Xhetani*)



¹ <http://kpa.al/shpallje>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE
DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

Nr. 1175/prot.
9

Tiranë, më 25.11.2024

Lënda: Dërgim informacioni

SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT KLORINDA ÇELA

Adresa: Rruga "Don Bosko", Vizion Plus, Kulla 3, Shk. 2, Ap. 7/5, Nr. 23, Tiranë.

Adresë alternative: klorindacela@gmail.com

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në datën 25.11.2024, ka marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën e gjyqtarit Sokol Çomo me objekt "Kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes (JR) nr. 1/2022, datë 05.01.2022".

Bashkëlidhur do të gjeni shkurtimin e vendimit nr. 22, datë 25.11.2024, të trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me vendimin nr. 13, datë 07.02.2022 ka vendosur pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, z. Ardian Hajdari.

Në vijim të vendimeve të mësipërme, më datë 25.11.2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, u hodh shorti për zëvendësimin e gjyqtarëve Sokol Çomo dhe Ardian Hajdari, nga trupi gjykues që do të shqyrtojë çështjen (JR) nr. 1/2022, datë 05.01.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Klorinda Çela.

Pas hedhjes së këtij shorti për caktimin e gjyqtarëve anëtarë dhe më pas, për relatorin e çështjes, përbërja e trupit gjykues është si më poshtë vijon:

Kryesuese: Ina Rama
Relatore: Mimoza Tasi
Anëtare: Rezarta Schuetz
Anëtare: Natasha Mulaj
Anëtare: Albana Shtylla



KRYETARI

Sokol Çomo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20-1/2022 (JR)
Datë 15.11.2024

Nr. 22 Vendimi
Datë 25.11.2024

SHKURTIM VENDIMI

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

sot, më datë 25.11.2024, në prezencë të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Steven Kessler, asistuar nga sekretare gjyqësore Ina Xhetani, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën e gjyqtarit Sokol Çomo me objekt “Kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes (JR) nr. 1/2022, datë 05.01.2022”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës trupi gjykues,

VENDOSI:

- 1- Pranimin e kërkesës së gjyqtar Sokol Çomo për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes (JR) nr. 1/2022, datë 5.1.2022 që i përket subjektit të rivlerësimit Klorinda Çela.
- 2- Të njoftohet gjyqtari Sokol Çomo me këtë vendim.

Kryesuese
Mimoza Tasi
d.v

Anëtare
Ina Rama
d.v

Anëtare
Natasha Mulaj
d.v

Anëtare
Rezarta Schuetz
d.v

Anëtare
Albana Shtylla
d.v

